



Pranimi / Dorezuar Prilipje/Prilidato Received/Delivered		28 - 04 / 3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMBSTICK	3947 / 2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.430/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.430/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.430/2023 e datës 28.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës për vitin 2022 për ankuesen.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 28.02.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimet ankimore se vlerësimi në fjalë nga ana e udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë është një farsë procedurale e përpiluar në mënyrë jo profesionale dhe subjektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme

dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli me datë 20.03.2023 nga kjo e fundit ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Me datën 12.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2151/2023 të datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 20.03.2023 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin për vlerësim për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2021 për ankuesen; Akt emërimit e ankueses me numër AE.Nr.55/2022 të datës 13.06.2022; Vendimin për sistemim të përhershëm të ankueses me numër Nr.Ref.63/2021 të datës 08.03.2021; Formularin PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses të datës 17.04.2015; Komunikimet elektronike në mes të ankueses dhe udhëheqësit të saj të datës 30.08.2022, 26.08.2022, 24.08.2022, 13.10.2022, 14.10.2022, 14.11.2022, 22.11.2022, 14.04.2023; Vendimin VK/2023 të datës 12.04.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankueses në Këshill si dhe komunikimet elektronike të datës 14.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e administruara të lëndës lidhur me çështjen e kontestuar si objekt shqyrtimi në këtë ankesë, konstatoi se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe se e njëjta tani sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit AE.Nr.55/2022 të datës 13.06.2022 ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Organizata Ndërkombëtare*, në Departamentin për Evropë, BE dhe Rajon-Divizioni për Evropë dhe BE.

Nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesja lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022, është vlerësuar vetëm për periudhën nga muaji qershor deri në muajin nëntor të vitit 2022, pasi që ka pas ndryshime të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt, mirëpo meqë nuk është kontestuar kjo periudhë nga ana e ankueses pjesa e vlerësimit për periudhën nga muaji janar deri në qershor, Kolegji ka shqyrtuar pjesën e vlerësimit sipas formularit të vlerësimit i hartuar nga ana e udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë për periudhën qershor-nëntor të vitit 2022 dhe i dërguar përmes e-mailit zyrtar të datës 31.01.2023 për ankuesen. Rrjedhimisht sipas Formularit për vitin 2022, ankuesja për këtë periudhë është vlerësuar me notë të përgjithshme prej 3.5.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vlerësimit të rezultateve në punë sipas Formularit për vitin 2022, pretendon se janë përpiluar detyra të cilat asnjëherë nuk i janë caktuar dhe në realizimin e të cilave as që

ka marrë pjesë qoftë si dëgjuese dhe përfshirja e detyrave pa qenë të sakta është shkelje e rregullores në fuqi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues.. , rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezulton së ankuesja për periudhën e qershor-nëntor të vitit 2022 është vlerësuar me notë të përgjithshme për këtë periudhë 3.5.

Andaj, në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, nota përfundimtare e vlerësimit nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë", përkatësisht "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performances e përgjithshme të institucionit, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se nuk është i bazuar pretendimi i ankuseses se vlerësimi i punës për vitin 2022 sipas formularit në fjalë është një farsë procedurale e përpiluar në mënyrë jo profesionale dhe subjektive, ngase mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 3.5 ka vlerësuar se ankuesja ka përmbushur dhe realizuar të gjitha objektivat e punës dhe se e njëjta ka tejkaluar pritjet sipas këtyre objektivave.


Nisur nga faktet si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.415/2023, datë 27.04.2023.

Ardita Perçuku-Shyfi



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Athen MEHIMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretariat te Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

